



RAPORT VJETOR I UNIVERSITETIT
PRIVAT
ALBANIAN UNIVERSITY
2019-2020



HYRJE

Albanian University ushtron aktivitetin e tij, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Albanian University, Rregulloren e Universitetit, si dhe Planin e Zhvillimit Strategjik 2017 - 2022. Albanian University paraqet Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore për vitin akademik 2019 - 2020 në nivel institucional, në kuadër të informimit dhe transparencës për veprimtarinë e tij, në përputhje me Udhëzimin nr.5, datë 19.02.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) “Përcaktimin e Elementëve Përbërës të Raportimit Vjetor dhe Afatit për Raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019.

Albanian University, prej 16 vitesh pjesë e Institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë kontribuon në arsimimin cilësor të brezave të rinj falë një game të gjerë programesh studimi të akredituara në 3 ciklet e studimit që ai ofron. Të gjitha këto programe studimi janë hartuar dhe zhvillohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke përmbushur Standardet Shtetërore të Cilësisë si dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Shtyllat kryesore në të cilat mbështet Albanian University janë cilësia akademike dhe kërkimi shkencor. Misioni i Universitetit është ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës i studentëve nëpërmjet një stafi akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore, me eksperiencë disa vjeçare në mësimdhënie si dhe me kualifikime të vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit, sikurse edhe një infrastrukturë bashkëkohore e vënë në dispozicion të programeve të studimit me vendndodhje në qendër të qytetit.

Albanian University kaloi me sukses procesin e akreditimit institucional periodik dhe gëzon një akreditim me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 01, datë 24.01.2020, i vlefshëm deri në 23.01.2023.

Në zbatim të misionit të universitetit dhe kuadrit ligjor në fuqi, ky raport synon të paraqesë aspektet kryesore të aktivitetit akademik në Albanian University, duke vënë theksin edhe në problematika të evidentuara dhe të adresuara për zgjidhje, me qëllim rritjen e mëtejshme të cilësisë.

Ky raport bazohet në raportet analitike të njësive kryesore (Fakultetet) të Albanian University, si dhe të strukturave të tjera. Konkretisht, ky raport është bazuar në:

- Raportin vjetor mësimor, kërkimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore;
- Raportin vjetor mësimor, kërkimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Shoqërore;
- Raportin vjetor mësimor, kërkimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave të Aplikuar dhe Ekonomike;
- Raporte informuese e analitike të organeve kolegjiale të AU-së (Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit);
- Raporte informuese e analitike të komisioneve në nivel universiteti (Komisioni për dhënien e gradës “Dr.”, Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisioni për vlerësimin Institucional, Komisioni për kërkimin Shkencor dhe Botimet Akademike Këshilli i Etikës, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë);
- Të dhëna statistikore të marra nga raportet që paraqesin regjistrimet e studentëve në programet e studimeve, rezultatet e studentëve dhe kalueshmërinë, transferimet, diplomimet, etj..



- Materiale, dokumente dhe informacione, të hartuara në kuadër të aktiviteteve të ndryshme të realizuara në nivel fakulteti, apo të zhvilluara nga personeli akademik i fakulteteve të Albanian University, etj.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur aktivitetin në tërësi të universitetit. Një kopje e këtij raporti dërgohet në MASR dhe një kopje publikohet në versionin elektronik në faqen zyrtare të webit të Albanian University.



Përmbajtja

A. Senati Akademik	7
<i>a. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.....</i>	7
<i>b. Informacion mbi bashkëpunime ndërinstucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.....</i>	8
<i>c. Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:</i>	19
<i>i) politikat e kërkimit shkencor</i>	19
<i>ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien</i>	19
<i>iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit.</i>	24
<i>iv) Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.....</i>	35
<i>d. Të dhëna mbi programet e studimit</i>	37
<i>i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar</i>	37
<i>ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit</i>	46
<i>iii) IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme të programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës</i>	47
<i>e. Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i>	48
<i>f. Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose moduln/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik</i>	



g. Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar:	52
i) përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar;.....	52
ii) përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar	54
h. Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	55
i. Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të ministrisë, duke përfshirë edhe:	55
i) një vlerësim të përgjithshëm të komunikimit me ministrinë dhe institucionet në varësi të saj, duke theksuar mbi përmirësimet e mundshme në këtë komunikim;.....	55
ii) vlerësime dhe rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore e nënligjore në fuqi që ndikojnë në veprimtarinë e IAL-së, të shoqëruar me arsyetime të hollësishme. 55	
j. Të dhëna mbi studentët si:.....	56
i) numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;	56
ii) numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore.	56
iii) numrin e studentëve të shkëlqyer;.....	56
iv) numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;.....	56
v) numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit.....	56
vi) pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre	62
vii) përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen.....	62
viii) një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi.....	62
B. Bordi i Administrimit:	63
a. Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse, etj. 63	
b. Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit	64



- c. Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim 64
- d. Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore..... 64
- e. Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare 64
- f. Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, në bashkëpunim me Senatin Akademik të institucionit të arsimit të lartë. 65



A. Senati Akademik

- a. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së

Raporti vjetor i “Albanian University” (AU) përkon me një vit të realizuar në kushte të një katastrofe natyrore si ajo e tërmetit të 26 Nëntorit dhe Pandemisë Covid-19 e cila detyroi mbylljen e universiteteve në 10 Mars 2020, në auditore dhe vazhdimin në distancë, deri në rifillimin e aktivitetit mësimor më 25 gusht 2020, bazuar në Urdhrin Nr. 104, datë 30.04.2020 nga MASR.

Albanian University fillon vitin akademik në përputhje me Urdhrin e Ministrit të Arsimit Rinisë dhe Sportit dhe kalendarin akademik të miratuar nga Senati Akademik në përputhshmëri me udhëzimet ligjore. Senati Akademik ka ushtruar kompetencat e tij në mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike gjatë të gjithë vitit akademik, nëpërmjet vendimeve të marra në mbledhjet përkatëse të cilat i janë adresuar njësisive përkatëse për zbatim. Senati akademik ka shqyrtuar dhe miratuar, me vendimet përkatëse, kuotat dhe kriteret e pranimit në programet e studimit që ofrojnë njësitë kryesore të AU-së për vitin akademik përkatës, si dhe propozimin për tarifatat e shkollimit për çdo program, marrëveshjet e bashkëpunimit me të tretë (IAL vendase dhe të huaja); ka shqyrtuar projekt propozimet për programet e studimit (ndryshime/përmirësime apo riorganizim) propozuar nga njësitë kryesore, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së ofertës akademike të AU etj.

Bordi i Administrimit ka ushtruar kompetencat e tij në mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare të AU-së, nëpërmjet vendimeve të marra ku një pjesë e mirë e tyre i dedikohet mbështetjes financiare të studentëve. Gjithashtu, Bordi i Administrimit ka shqyrtuar dhe miratuar tarifatat për të gjitha ciklet e studimit, bursat apo reduktimet e tarifave për studentët që plotësojnë kriteret sipas akteve ligjore e nënligjore përkatëse, buxhetin e institucionit etj. Bordi i Administrimit kryen veprimtarinë e tij në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSh".

Rektorati, Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve kanë qenë të angazhuar për mbarëvajtjen e procesit mësimor, monitorimin e regjistrimit të studentëve, menaxhimin e personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, raportimet periodike, si dhe për zgjidhjen e mjaft problematikave të evidentuara gjatë zhvillimit të procesit mësimor, sezoneve të provimeve, praktikave profesionale dhe diplomimit, falë vështirësive të hasura sidomos gjatë semestrit të dytë të zhvilluar në distancë.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), në fillim të vitit akademik organizoi trajnime për personelin akademik, si një element i rëndësishëm i politikave të institucionit për ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të sigurimit të cilësisë. Trajnimet me lektorë dhe tema të zgjedhura për shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet personelit akademik mbi organizimin e klasës, vlerësimin psikosocial dhe motivimin e studentëve, si dhe teknologjitë e mësimdhënies ishin në qendër të vëmendjes. Gjithashtu, nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, është realizuar rishikimi i programeve të studimit, në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm, në përputhje me nevojat e diktuar nga studimi i tregut të punës, si dhe përditësimi i



syllabuseve. NjSBC, në ushtrim të kompetencave të saj, për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit NjSBC ka hartuar 3 pyetësorë specifikë për mësimdhënien online (distancë), mësimin online, si dhe për punën në distancë, përkatësisht drejtuar personelit akademik, studentëve, dhe stafit administrativ, gjatë periudhës së pandemisë për shkak të covid-19.

Vëmendja e këtij viti konsistoi në implementimin dhe përshtatjen për herë të parë edhe të platformave elektronike në semestrin e dytë, me ndërprerjen e mësimin, me urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë dhe atij të Arsimit Sportit dhe Rinisë për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia e COVID-19. Albanian University organizoi menjëherë një sistem online bazuar në platforma digjitale dhe mësimi rifilloi duke u zhvilluar në distancë. Format e realizimit të tij kanë qenë interaktive nëpërmjet video-konferencave live me studentët, video-regjistrimeve apo leksioneve të postuara, ku për realizimin e gjithë procesit akademik dhe mësimor, janë përdorur Platformat Microsoft Teams dhe Exam.net. Zhvillimi i mësimin, por jo vetëm (mbledhjet në nivel njësisish dhe ato institucionale, axhendat e akreditimeve dhe aktivitetet në proces, mes institucionit dhe palëve të tjera) u realizua në këto platforma sipas Manualeve të mirë përcaktuar paraprakisht dhe të vëna në dispozicion, një sfidë për të gjithë kjo, në kushtet e Pandemisë Covid-19 dhe veçantive të saj në Shqipëri, e sidomos në arsim dhe shëndetësi. Përpjekjet maksimale mundësuan realizimin në masën 80% të planeve dhe objektivave të miratuara në fillim të vitit akademik 2019- 2020, kjo falë shtyrjes së vitit akademik deri në Tetor 2020 ku studentët e programeve të profesioneve të rregulluara arritën të realizonin praktikat profesionale sipas parashikimeve në kurrikulat mësimore.

Një shqetësim mbetet realizimi i kërkimit shkencor në këto kushte të vështira pandemie, por Institucioni i AU, në bashkëpunim me Njësitë Kryesore dhe Njësitë Bazë, bazuar në njoftimet zyrtare të MASR si edhe AKKSHI ka mbështetur stafin akademik për aplikime në projektet Kombëtare dhe Ndërkombëtare, duke njoftuar në kohë reale për thirrjet dhe aplikimet. Gjatë semestrit të parë stafi është mbështetur edhe me anë të trajnimeve të organizuara për mënyrën e shkrimit të projekteve. Rezultatet e Aplikimeve kanë qenë të pranueshme për situatën, duke rezultuar të suksesshme me fitimin e disa granteve e projekteve, si dhe me finalizimin me sukses të studimeve doktorale që ndodheshin në proces.

Studentët janë të organizuar në këshilla studentorë si dhe kanë marrëdhënie të ngushta me stafin akademik, nëpërmjet sistemit të mentorimit dhe tutoriatit. Studentët mbështeten dhe kanë akses në një gamë të gjerë të aktivitetetve sociale dhe komunitare, por kjo mbështetje mbetet gjithsesi e kufizuar. Universiteti ka forcuar mbështetjen ndaj studentëve, konkretisht mbështetja e karrierës nëpërmjet projektit GRADUA.

- b. Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitutionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim



Projekte të fituara

Tabela 1

Nr.	Dt. e PRITUR APLIKIM	TITULLI I PROJEKTIT	THIRRJA	DONATORI	INSTITUCIONET APLIKUESE	STADI	PËRSHKRIM I PROJEKTIT
1	2018-2020	Digjitalizimi Inventarëve të Fondeve të Arkivave Vendore	Drejtoria e Përgjithshme me Arkivave		Albanian University. Fakulteti i Shkencave Shoqërore	Projekt i fituar	Përfshirje e studentëve të FSHSH në projektin e Digjitalizimit të Inventarëve të Fondeve të Arkivave Vendore të Viteve 1945-2008 të Ish-Komiteteve Ekzekutive.
2	2018-2020	Projekti i Organizimit të 100 vjetorit të Parlamentit Shqiptar, Akademia e Studimeve Albanologjike dhe Kuvendi i Shqipërisë.	Kuvendi i Shqipërisë	Kuvendi i Shqipërisë	Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative	Projekt i fituar	Ky projekt ofrohet për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, në funksion të praktikës mësimore (Arkiva Qendrore e Shtetit, Arkiva e Kuvendit të Shqipërisë dhe Ambientet e F.SH.SH; Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative).
3	2019	Building Capacity on Community Health Resilience	28242/660 83 TAIEX;	BE	Albanian University Qendra Shëndetësore dhe Universitete Shqiptare	Projekt i fituar	Projekt i Komisioni European në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik dhe AU. Rritja e kapaciteteve të Grupeve për përgjigjen në rastet e emergjencave



4	21.10.2020	Key Action 1 - Mobility for learners and staff - Higher Education Student and Staff Mobility. Inter-institutional agreement 2020-23 between institutions from programme and partner countries UNINA-AU		BE	Albanian University Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Farmacisë	Projekt i fituar	3 studentë (18 muaj) nga Departamenti i Farmacisë në Itali 2 anëtarë të stafit akademik për mësim-dhënie (26 ditë) dhe 1 për trainim (7 ditë) nga Shqipëria në Itali
5	2020	Jean Monnet Module "EU Western Balkan Cooperation on Justice and Home Affairs			Projekt në bashkëpunim me Universitetin e Salernos dhe Departamentit të Shkencave Juridike të Fakultetit të Shkencave Shoqërore	Projekt i fituar.	Ky mobilitet bëri të mundur që 4 studentë të Departamentit të Shkencave Juridike të zhvillonin semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020 pranë Universitetit të Salernos. Gjithashtu, në kuadër të këtij bashkëpunimi një personel akademik zhvilloi një mobilitet një javor në Universitetin e Salernos.
6	07.08.2017 /rinovuar 12.04.2019	KA 1 - Higher Education Student and Staff mobility në bashkëpunim me Universitetin e Salernos			Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Departamenti i Inxhinierive		Nga ky program, gjatë semestrit të dytë të v.a. 2019 - 2020, kanë përfituar mobilitet në Universitetin e Salernos 7 studentë: 5 studentë nga programi i studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Elektronike" dhe 2 studentë nga programi i studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Kompjuterike".



7	10.12.2018	CIII-BG-0722-04-1516 "Computer Aided Design of Automated Systems for Assembling" - CEEPUS					Në kuadër të këtij programi në muajin prill 2020, ishte planifikuar një ekskursion i shkurtër studimor për 4 studentë dhe shkëmbim për 3 pedagogë. Vizita nuk u realizua për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid - 19.
8	Tetor 2019	AKKSHI me Kosovën "Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme"				Projekt i fituar.	
9	Tetor 2017-Tetor 2020	GRADUA	Erasmus + CBHE	BE	Albanian University.	Projekt i fituar.	Projekti GRADUA do të mbështesë Universitetet Shqiptare duke implementuar një model të integruar të kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve nëpërmjet: mbledhjes së të dhënave për performancën e të diplomuarve; lehtësimin e bashkëpunimit midis IAL-ve dhe biznesit; lehtësimin e vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës.
10	Mars 2019	STITCH	2019 CAL EAC/A03/2018	BE	Albanian University, Fakulteti I Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Departamenti i Art Dizajn. Në partneritet me	Projekt i fituar	Historiku i Veshjeve Tradicionale: Inovacioni Dixhital për Ruajtjen e Trashëgimisë Tekstile Evropiane.



					HACER CREATIVO SL, Spain, FONDAZIONE MUSEO DEL TESSUTO DI PRATO Italy, MOHOLY-NAGY MUVESZETI EGYETEM Hungary.		
11	2020- 2023	Erasmus + KA1 2020-2023	Higher Education Student and Staff mobility Erasmus + KA1 2020-2023		Universiteti Napolit dhe Albanian University.	Projekt i fituar	Departamenti i Farmacisë, Erda Qorri.
12	19.06.2020	Video Tele Conference: Workshop on the use of block chain technology to support the public administration during the Covid - 19 crisis	TAIEX event	ETT 70621 ALBANIA	Fakulteti i Shkencave Mjekësore	Projekt i fituar	Fakulteti i Shkencave Mjekësore (Erda Qorri.)
13	07.10.2019-2021	Erasmus+ KA1 2019-2021- IT02-KA107-061955	Student and Staff mobility	BE	Universiteti Pisës dhe Albanian University.	Projekt i fituar	Higher Education Student and Staff mobility Erasmus + KA1 2019-2021 Universiteti i Pisës dhe Albanian University 2019-1-IT02-KA107-061955. Projekt i fituar Erda Qorri.
14	13.07.2020	COVID-19 Extraordinary Call for Proposals: <i>DISTANCE LEARNING ON</i>	MASR	BE	Albanian University Fakulteti i Shkencave Mjekësore	Projekt i fituar	Mapping the equipment in public microbiology labs in Albania, distance e- learning in epidemic and pandemic.



		<p>EPIDEMIC AND PANDEMIC OUTBREAKS IN THE WESTERN BALKANS: ALBANIA, BOSNIA AND HERZEGOVINA, MONTENEGRO, NORTH MACEDONIA, SERBIA (Ref No. 305.1521-20)</p>					
--	--	--	--	--	--	--	--

Projekte të aplikuara

Tabela 2

Nr.	Dt. e PRITUR APLIKIM	TITULLI I PROJEKTIT	THIRRJA	DONA TORI	INSTITUCIONET APLIKUESE	STADI	PËRSHKRIM I PROJEKTIT
1	15/02/2019	Education for Industry 4.0 / eIND4.0	CAPACITY BUILDING IN THE FIELD OF HIGHER EDUCATION; Joint Projects.	EU	<ul style="list-style-type: none"> • Minimumi një IAL nga të paktën dy nga vendet e Programit që marrin pjesë në projekt; • minimumi tre HEI nga Vendi Partner që marrin pjesë në projekt. 	Projekti l shkruar në masën 80% nga AU, Departamenti i shkencave Ekonomike dhe Zyra e Projekteve.	Objektivi kryesor i propozimit eIND4.0 është krijimi i aftësive inovative teknologjike dhe menaxhuese në konutet e ndryshme jo të BE-së për të ndihmuar kompanitë vendore private dhe publike që të përfitojnë më së shumti nga mundësitë e ofruara nga digjitalizimi dhe automatizimi i



						Faza e kërkimit të partnerëve.	proceseve industriale. Objektivat e projektit janë: I) modernizimi dhe ndërkombëtarizimi i sistemit të tyre kombëtar të arsimit duke filluar një bashkëpunim ndërkombëtar për një përmirësim të vazhdueshëm, (ii) krijimi i lidhjeve të duhura për shpërndarjen e rezultateve të hulumtimit në sektorin e industrisë / sektorit privat.
2	25-03-2019	UNIVERSITY PEDAGOGY: UNIVERSITY TEACHING ON THE SPOT	Form ID: KA203-34D97143	BE	Albanian University, Dr. Genta Rexha Departamenti i Inxhinierive	Projekt i Aplikuar	Aplikim në projektin me titull: UNIVERSITY PEDAGOGY: UNIVERSITY TEACHING ON THE SPOT Action: Strategic Partnerships for higher education (KA203) -
3	2018-2019	FINLEAD	Erasmus +	BE	Albanian University, Departamenti i Shkencave Ekonomike	Projekt i aplikuar	Projekt i Departamentit të Ekonomisë në bashkëpunim me Wrocław University of Science and Technology [Ëust] Poland.
4	2018-2019	STITCH	2019 CAL EAC/A03/2018	BE	Albanian University, Departamenti i Shkencave Ekonomike	Projekt i aplikuar	Projekt i Departamentit të Ekonomisë në bashkëpunim me Hacer Creativo Sl, Spain, Fondazione Museo del Tessuto di Prato Italy, Moholy-Nagy Muvezseti Egyetem Hungary
5	2018-2019	Produkti i Punës Shkencore të Profesoratit Shqiptar në Shkencat Sociale: Një Analizë Statistike e			Albanian University, Departamenti i Shkencave Ekonomike Prof.Asoc. Manuela Mece & Edmond Cata ekspert	Projekt i aplikuar	

		Cilësisë dhe Faktorëve Ndikues					
6	2018-2019	COEXIST	Horizon 2020	BE	Albanian University, Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore	Projekt i aplikuar	Consourcium : Koordinator Trilateral Research, Partnere-Vienna Centre for Societal Security-VICESSE, Albanian University, NEXUS, Civil Concept Forum MNE, Centro Studi Internazionali- Ce.S.I.
7	Tetor 2019	KIDPIOS	AKSHI	BE	Albanian University, Fakulteti I Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Departamenti i Shkencave Ekonomike. Në partneritet me Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë, Kosovë	Projekt i aplikuar	Promote Financial Education among youngsters. (Promovim i Edukimit Financiar mes të rinjve)
8	Mars 2020		H2020	BE	Albanian University, Fakulteti I Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Departamenti i Shkencave Ekonomike. Në partneritet me RCISD, Hungary.		Educational research and development, in particular of projects which focus on reversing educational inequalities. (Kërkimi dhe zhvillimi arsimor, në veçanti i projekteve që përqendrohen në përmbysjen e pabarazive arsimore)



9	2018-2019	Inter-institutional agreement. Higher Education Student and Staff Mobility. Mobility for learners and staff™	KA1 - Erasmus+	BE	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore	Projekt i aplikuar	Projekt i Fakultetit të Mjekësisë në bashkëpunim me Universitetea “G. Popa”, Iași, Romania për shkëmbi stafi dhe studentësh në kuadër të Erasmus +.
10	2018-2019	Support to Civil Society Organizations for the Implementation of Capacity Building Actions to Increase Policy Dialogue and Awareness on European Integration	Process CFCU-IPA Europe Aid/161968/DH/ACT/AL IPA II	BE	Albanian University, Departamenti i Shkencave Ekonomike	Projekt i aplikuar	Projekt i Departamentit të Ekonomisë në bashkëpunim me ICLA
11	2018-2019	Assessment of burden of morbidity and mortality attributed to ambient air pollution in Albania.	Civil Society Scholar Aëards	Soros Foundation	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, ISHP Tiranë	Projekt i aplikuar	Projekt i Fakultetit të Mjekësisë në bashkëpunim me ISHP Tiranë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe me ISS Roma, Italy,



12	2019-2022	AKMI Anonymous Educational Organization, AKMI	Innovative VET Mobility Ways for Western Balkans "MobiWays" (hereinafter referred to as "the grant agreement" ëith the European Commission (hereinafter referred to as "the Commission"))		Albanian University, Departamenti i Shkencave Ekonomike & ICLA	Projekt i aplikuar	Projekt i Departamentit të Shkencave Ekonomike në bashkëpunim me ICLA
13	20/04/2020	Doctors of 21st Century: Learnig to Learn Action: Strategic Partnerships for higher education	(Form ID: KA203-3113A443, Applicant organization: GAZI UNIVERSITY		Applicant organization: GAZI UNIVERSITY dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Stomatologjisë Nilena Eriksen	<i>Projekt i aplikuar</i>	Nuk është fituar



Projekte në proces aplikimi

Tabela 3

N r.	Dt. e PRITUR APLIKIM	TITULLI I PROJEKTIT	THIRRJA	DONAT ORI	INSTITUCIONET APLIKUESE	STADI	PËRSHKRIM I PROJEKTIT
1	15.10. 2019	Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme	S&T Programi i bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës	AKKSHI	AU, Departamenti i Inxhinierive Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina, Departamenti i Mekatronikës	Në aplikim	Projekt kërkimor shkencor në fushën e Inxhinierisë Mekatronike



- c. Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:
- i) politikat e kërkimit shkencor

Politikat e Albanian University në fushën e kërkimit shkencor janë në funksion të misionit të Albanian University dhe të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Në këtë kuadër institucioni është i angazhuar të ndërmarrë një sërë politikash, me qëllim zhvillimin e kërkimit shkencor.

Albanian University me tre Fakultetet e tij, njësitë bazë mësimore-shkencore, kanë për detyrë të organizojnë dhe të administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar lirinë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Departamentet monitorojnë rregullisht punën kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe koordinojnë dhe mbështesin aktivitetet kërkimore të personelit akademik. Personeli akademik në funksion të promovimit të tij, si dhe të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe kërkimor - shkencor të institucionit, në fillim të çdo viti akademik paraqet planin e veprimtarisë së tij shkencore. Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik, ai paraqet një raport të përmbushjes së planit të veprimtarisë së tij kërkimore shkencore.

Albanian University ka në vëmendjen e tij realizimin e objektivave strategjike për zhvillimin e kërkimit shkencor duke nxitur aplikimet për projekte kërkimore shkencore në nivel njësie bazë apo kryesore si edhe nëpërmjet Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike.

Edukimi në vazhdim është një tjetër element i rëndësishëm i cili është në vëmendje të AU si pjesë e kërkimit shkencor në shërbim të stafit akademik, studentëve, profesionistëve të profesioneve të rregulluara. Njohuritë e marra dhe implementimi i tyre vihet në shërbim të komunitetit duke rritur cilësinë e shërbimeve përkundrejt të tretëve.

Produkt shkencor i AU, Revista Optime, në vitin e 11 të botimit është një tjetër mundësi për pasqyrimin e kërkimit shkencor nëpërmjet botimit të rezultateve të studimeve kërkimore shkencore të realizuara brenda apo jashtë institucionit.

- ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Mësimdhënia në Albanian University është e lidhur ngushtë me kërkimin shkencor e reflektuar kjo me realizimin e studimeve apo projekteve kërkimore shkencore nga ana e stafit akademik. Rezultatet e studimeve bëhen objekt diskutimesh përgjatë orëve në auditor me studentët me qëllim motivimin e studentëve për t'u afruar me kërkimin shkencor, si dhe zhvillimi i detyrave të kursit ku studentët zhvillojnë aftësitë e tyre mbi metodologjitë në kuadër të kërkimit shkencor. Gjithashtu, përgjatë vitit akademik organizohen konferenca shkencore studentore, ku studentët prezantojnë rezultatet e punëve shkencore të realizuara me mbështetjen e stafit akademik. Edhe në këtë vit akademik të vështirë, me gjithë sfidat që nxori, u bë e mundur të zhvillohej nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, në bashkëpunim me Këshillin Studentor, Konferenca e 14-të Shkencore Studentore.

Mbi të gjitha kërkimi shkencor është i lidhur me punën kërkimore të studentëve doktorantë dhe udhëheqësve të tyre, ndaj duhet të theksohet fakti i rëndësishëm për vitin akademik 2019- 2020, ai



i përbylljes me sukses të studimeve të doktoratës të 11 doktorantëve me vlerësimin “shumë mirë”. Vlen për tu përmendur finalizimi me sukses, si dhe risia që sjellin temat e tyre, jo vetëm në Albanian University, në përputhje kjo me planin Strategjik të tij, por me rëndësi për t’u marrë në konsideratë edhe nga aktorë të tjerë me ndikim thelbësor në zhvillimin ekonomik dhe jetik në rrafshin kombëtar. Më poshtë ju prezantohet një informacion i përmbledhur i doktorantëve dhe temat e tyre të mbrojtura gjatë vitit akademik 2019- 2020. Të gjitha programet e ciklit të tretë doktoratë ku doktorantët kanë qenë pjesë e tyre, u janë nënshtruar procesit të akreditimit nga ASCAL, duke kaluar me sukses dhe akreditimin e tyre.



Tabela 4

ALBANIAN UNIVERSITY INFORMACION MBI DOKTORTANTËT QË KANË MBROJTUR GRADËN SHKENCORE "DOKTOR"											
Nr	Emër	Mbiemër	Shtetësia	Gjinia	Forma e studimit	Tema e disertacionit	Regj. në studimet e doktoratës	Linku web në të cilën është publikuar disertacioni	Vendimi i jurisë	Fusha e studimit	Udhëheqës shkencor
1	Elona	Hoxha	Shqiptare	F	KP	Kontrata kolektive e punës në Shqipëri në këndvështrimin e Bashkimit Europian	21.03.2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktoratura-elona-hoxha/	Nr. 546/5 Prot. Dt.21.10.2020	Drejtësi, programi "E drejtë Europiane dhe e Kontratave"	Prof. Dr. Kudret Çela
2	Hazir	Elshani	Kosovare	M	KP	Prapambetja mendore/aftësia e kufizuar intelektuale	21.09.2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktoratura-hazir-elshani/	Nr. 545/5 Prot. Dt.20.10.2020	Psikologji Klinike	PhD. Eglantina Dervishi
3	Amanda	Gjyli	Shqiptare	F	KP	Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut	21.03.2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktoratura-amanda-gjyli/	Nr. 402/5 Dt.11.09.2020	Shkenca Administrative	Prof.Asoc.Dr . Ervin Karamuço
4	Leudita	Ademi (Doçaj)	Shqiptare	F	KP	Administrimi i politikave kryesore në BE, pas Traktatit të Lisbonës. Risi dhe problematika	21.03.2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktoratura-leudita-docaj-ademi/	Nr. 403/5 Dt.11.09.2020	Shkenca Administrative	Prof.Asoc.Dr . Ervin Karamuço



5	Aurora	Braçe (Napuçe)	Shqiptare	F	KP	Farmakovigjilenc a- një komponent i rëndësishëm rregullator për sigurinë e barnave në vëndet në zhvillim	21.03. 2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktoratura-aurora-brace-napuce/	Nr. 398/5 Dt.15.09. 2020	Shkenca Farmaceuti ke	Prof.Dr. Vera Ostreni
6	Mimoza	Maloku Kuqi	Kosova re	F	KP	Tiparet e personalitetit dhe kapacitetet njohëse tek fëmijët e moshës shkollore që vuajnë nga epilepsia	21.09. 2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktoratura-mimoza-maloku-kuqi/	Nr. 373/5 Dt.16.09. 2020	Psikologji Klinike	PhD. Eglantina Dervishi
7	Teuta	Beka	Kosova re	F	KP	Kontrata e ndërtimit sipas legjislacionit në Kosovë dhe pajtueshmëria e saj me të drejtën e Bashkimit Evropian	21.03. 2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktoratura-teuta-bega/	Nr. 335/5 Dt.22.09. 2020	Drejtësi, programi "E drejtë Europiane dhe e Kontratave"	Prof.Dr. Mariana Tutulani- Semini
8	Kostika	Çobanaqi	Shqiptare	M	KP	Kontrata e Qirasë Financiare (Leasing), Legjislacioni dhe Realiteti Shqiptar në Rrugën e Integritimit European	21.03. 2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktoratura-kostika-cobanaqi/	Nr. 261/5 Dt.22.06. 2020	Drejtësi, programi "E drejtë Europiane dhe e Kontratave"	Prof.Asoc. Dr. Fatmir Tartale
9	Bukurie	Haxhia (Kallanxhi)	Shqiptare	M	KP	Administrimi Modern dhe Roli i tij në Integrimin	21.03. 2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktoratura-bukurie-haxhia-kallanxhi/	Nr. 262/5 Dt.22.06. 2020	Shkenca Administrati ve	Prof.Asoc. Dr. Manuela Meçe



						European të Shkollës Sonë		ura-bukurije-kallanxhi/			
10	Ilda	Kadrimi	Shqiptare	F	KP	Sfidat e Politikës Fiskale për Vendet që i Bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)	21.03.2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktorat-ura-ilda-kadrini/	Nr. 263/5 Dt.22.06.2020	Shkenca Administrative	Prof.Asoc. Dr. Artur Ribaj
11	Silva	Ibrahimi	Shqiptare	F	KP	Prototipi Psikodinamik i Stileve të Lidërshiptit Përmes Tabelës së Organizimit të Personalitetit, Perspektiva e Re e Q-sort	21.03.2013	https://albanianuniversity.edu.al/download/doktorat-ura-silva-ibrahimi/	Nr. 264/5 Dt.22.06.2020	Psikologji Klinike	Prof. Dr. Vera Ostreni

- iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit.

Tabela 5

Veprimtaritë e zhvilluara nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike		
Konferenca	Leksione të hapura	Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj)
	<p>Takimi me regjizorin e njohur nga Kosova, Burim Haliti, në ditën e parë të leksioneve me studentët e Vitit të Dytë, në Laboratorin e Multimedias në Albanian University. Short Movie "HEKURISHTJA" Directed by Burim Haliti, 25.10.2019.</p> <p>Leksioni i hapur "Projektet europiane: Nga ideja tek implementimi" nga Prof. Asoc. Vittorio Scarano nga Universiteti i Salerno - 29.01.2020.</p> <p>Moduli me temë "Cloud Computing: fundamentals and platforms" nga Prof. Asoc. Vittorio Scarano nga Universiteti i Salernos - 27 - 31.01.2020.</p> <p>Leksioni i hapur "Projektet europiane: Nga ideja tek implementimi" nga Prof. Asoc. Vittorio Scarano nga Universiteti i Salerno - 29.01.2020.</p>	<p>Vizitë studimore në laboratorin e "Sistemeve te Energjisë" të shkollës së mesme profesionale "Don Bosko" - 14.01.2020.</p> <p>Vizitë e studentëve <i>Bachelor</i> në Inxhinieri Mekatronike dhe Inxhinieri Elektrike në TEC-in e Vlorës - 18.01.2020</p> <p>Përgatitja e "Seri Grafike e Katalogut Studimor" per Ekspozitën "100 vjetori i Parlamentarizmit Shqiptar" studente Ina Burimi nën drejtimin e Prof. Kaliopi Naska, 06.07.2020.</p>



	<p>Leksioni i hapur "Information security ëith real-world examples and Q&A" nga specialisti amerikan i fushës Daniel Bohannon - 21.01.2020.</p> <p>Leksion i hapur "Sistemet e automatizimit ne sera" - PhD Donald Selmanaj - 19.02.2020.</p>	
<p>Veprimtaritë e zhvilluara nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore</p>		
<p>Fakulteti i Mjekësisë Dentare (FMD) - Albanian University - Kongresi i 3-të i Fakultetit të Mjekësisë Dentare me temë: "Zhvillimet bashkëkohore në fushën e Denstistrisë dhe të Shëndetit Oral", 14-15 nëntor 2019, Tiranë</p> <p>Shoqata e Stomatologëve Shqiptarë - Albanian University - Kongresi i Shtatë Mbarëshqiptar i Stomatologjisë 4-6 Dhjetor 2019, Tiranë.</p> <p>Konferenca e 14-të studentore e Departamentit të Stomatologjisë "Evolution of oral care and clinical dentistry - Neë challenges during COVID-19 pandemic", 23.09.2020, Tiranë</p> <p>Konference studentore "Praktikat e reja infermierore dhe fizioterapeutike" 29.10. 2020.</p>	<p>Leksion i Hapur nga Prof.Francesco de Ponte "Kirurgjia Orale dhe Maxilo Faciale", 15 Nëntor 2019, Tirane.</p> <p>Leksion i Hapur nga Prof.Ioannis Georgakopoulos "Groëth Factor and Implantology", 15 Nëntor 2019, Tirane.</p> <p>Leksion i Hapur nga Dr. Loreta Pojani "Koncepte Themelore në hartimin e Temës së Diplomës", 21 Nëntor 2019, Tiranë</p> <p>Leksion i hapur nga Dr. Radoslaë Jadach në Kirurgji Orale: "Oral Surgery, "Flap Design and Sutures", "Sinus lift", "split crest", "Soft tissue and Management of Complication", 10 Tetor 2020</p> <p>Leksion i hapur "From brackets to aligners: The pleasure of choice" me Prof. Giovanni Manes Gravina, Tetor 2020.</p> <p>Leksion i hapur "External Rigid Fixation of Condyle Fractures" me Prof. Claudio Taglia, Tetor 2020.</p>	<p>Workshop "Trajtim Ortodontik tek Adultët" kurs në Typodent nga Dr. Giovanni Biondi - 4-5-6 Dhjetor 2019, Tirane.</p> <p>Albanian University, Mbrojtja e diplomave të studenteve të Stomatologjisë - 1 korrik 2020, Tiranë</p> <p>Tema "Përgatitja e Temës së Diplomës për Punime të Kërkimit Shkencor dhe Epidemiologjike" 14.Dhjetor 2019, Dr. Delina Xhafaj.</p> <p>DEKRA AKADEMIE, mundësi për infermierët që duan të punojnë në Gjermani (nga Jonida Gjuzi) datë 21/11/2019, Albanian University</p> <p>"PREMIUM GROUP ALBANIA & JONAS" MBI MUNDESITË E PUNËSIMIT NË BERLIN (nga Z.Ralf Moller-Flohr dhe Z. Maks Gerbi), datë 14/07/2020, Platforma Online Microsoft TEAMS.</p>



	<p>Ndihma e shpejtë, metoda dhe raste të ndryshme të dhënies së ndihmës së shpejtë (nga Prof.Elson Jacaj), date 23/01/2020, Albanian University</p> <p>Roli i mjekut dhe fizioterapistit në sport (nga Gianluca Stessina, Mjek i Kombëtares Shqiptare të Futbollit/ Juventus Medical), date 23/01/2020, Albanian University</p> <p>HIV/AIDS, date 14/05/2020, Platforma Online TEAMS</p>	
Veprimtaritë e zhvilluara nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore		
<p>11 tetor 2019- Studentët dhe stafi akademik morën pjesë në Konferencën e II-të Studentore Ndërkombëtare në Pogradec, me temë "Problematika, sfida dhe risi mbi zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies në Shqipëri".</p>	<p>Leksion i hapur "Projektet europiane: Nga ideja tek implementimi"</p> <p>Profesor Vittorio Scarano nga Universiteti i Salernos, në vizitë pranë Albanian University në kuadër të programit Erasmus+, solli eksperiencën e tij në aplikimet në projekte europiane dhe më konkretisht në Horizon 2020 me projektin e tij fitues ROUTE TO PA.Eksperienca,Ideja, Paraqitja e saj dhe Ekipi.</p> <p>10 tetor 2019: Studentët dhe stafi akademik i Albanian University morën pjesë në trajnimin e bërë në amjentetet e Bibliotekës Kombëtare, Salla Franceze.</p> <p>21 tetor 2019: Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë zhvilloi një cikël leksionesh të hapura me studentët e AU. Studentët u</p>	<p>Nëntor 2019: Takim informues 'Çfarë është Erasmus + dhe si të bëhemi pjesë?!'</p> <p>20 janar 2020 - Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes organizoi aktivitetin TRYEZË e RRUMBULLAKËT me temë: "Simulimi i një ore mësimi për mësimdhënien e gjuhës Angleze - An English Language Teaching hour"</p> <p>'Planifikimi dhe struktura e një ore mësimi. Kompetencat dhe të nxënit. Metodot dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës angleze'- Leksion i hapur nën kujdesin e pedagoges Dr. Elona Limaj, si dhe me pjesëmarrjen e studentëve të programeve të studimit Bachelor</p> <p>22 janar 2020 - Pranë ambienteve të bibliotekës në Albanian University, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes organizoi një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrjen e Akademikut</p>

<p>njohën me mjetet të cilat lehtësojnë dhe ndihmojnë qasjen në informacion, si Katalogët online, Katalogët e digjitur, Biblioteka digjitale, e-Bibliografi, Fletëkerkesa elektronike, etj.</p> <p>20 nëntor 2019: Leksion i Hapur me temë: “Matje e Performancës - Instrument i përmirësimit të vazhdueshëm të KLSH-së Kontrolli i Lartë i Shtetit në bashkëpunim me AU, (Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Fakultetin e Shkencave Shoqërore)</p> <p>18 dhjetor 2019: Debat i Hapur. Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative, Departamenti i Shkencave Juridike, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Politike organizojnë një “Debat të Hapur” me temë: "Monitorimi dhe Impakti i akteve të munguara ligjore".</p> <p>2 mars 2020: "Albanian University" e perfaqesuar nga drejtuesi i Departamentit të Shkencave Juridike, PhD Ismail Tafani, në Jean Monnet Module "EU Ëestern Balkan Cooperation on Justice and Home Affairs" i mbajtur pranë Universitetit të Salernos.</p> <p>30 prill 2020: Në Universitetin e Salenos në Itali në kuadër të modulit Jean Monnet EU ËEB, një projekt i cili realizohet edhe në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Juridike në Albanian University, 30/ 04/ 2020 u mbajt një leksion me titullin: “Shkëmbimi i informacionit,</p>	<p>Gjovalin Shkurtaç, Stafit Akademik të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, studentët e programeve të studimit: Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, Bachelor në “Anglisht”, mbi Monografinë me titull: “NDIKIME NË FJALËFORMAT E SHQIPES” me Autor Ethem Likaj, Gilberta Hadaj.</p> <p>29 janar 2020 -Tryezë e rrumbullakët me temë: "SI TE FILLQJME DHE TE MBYLLIM NJE PREZANTIM"</p> <p>‘Round table - metodat bashkëkohore të mësimdhënies’: Përfaqësues të stafit akademik të Albanian University prezantuan dhe shkëmbyen eksperiencën e tyre mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Prezantimi i teknikave nga pedagogë të fushave të ndryshme rezultoi mjaft motivues, për një efikasitet më të lartë në përfitimin e kompetencave të të nxënit. Ky aktivitet u realizua në kuadër të trajnimeve të përvitshme të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Stafi i Albanian University, së bashku me disa studentë dhe alumni (të diplomuar të tij), kanë marrë pjesë në takimin e rradhës së zhvilluar në datat 22-24 tetor në ambientet e FSHMT, në kuadër të Projektit GRADUA. Albanian University është partner, së bashku me disa universitete të tjera shqiptare dhe europiane, në këtë projekt të financuar nga Programi Erasmus + me mbështetjen e Komisionit Europian. Platforma GRADUA ju vjen në ndihmë studentëve duke i krijuar një urë lidhëse me tregun e punës. Falë regjistrimit në platformën GRADUA, studentët mund të krijojnë CV-në e tyre personale, të kenë qasje të lehtë në informacion mbi mundësitë e punësimit/ praktikës profesionale, të përgjigjen në oferta pune direkt</p>
---	---

	<p>Aktivitetet e Inteligjencës dhe Ekipet e Përbashkëta të Hetimit (JITs); Roli i Shkollës Shqiptare të Magjistraturës” i cili u zhvillua në platformën Microsoft Teams.</p>	<p>përmes platformës, të kontaktohen nga kompanitë, etj.</p> <p>16 janar 2020 - Pranë ambienteve të Bibliotekës në Godinës Qendrore të “Albanian University”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes zhvilloi aktivitetin shkencor: TRYEZË e RRUMBULLAKËT, nën kujdesin e pedagoges Dr. Esmeralda Strori si dhe me pjesëmarrjen e studentëve të programeve të studimit: Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”.</p> <p>5 shkurt 2020 - Në ambientet e “Albanian University”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes zhvilloi aktivitetin: TRYEZË TË RRUMBULLAKËT me temë: "NJOHURI MBI ASPEKTET FONETIKE DHE FONOLOGJIKE NGA NJE KENDVESHTRIM KRAHASUES MIDIS GJUHES ANGLEZE DHE SHQIPE - INSIGHT ON PHONETICAL AND PHONOLOGICAL ASPECTS FROM A PERSPECTIVE OF COMPARATIVE ANALYSIS BETWEEN ALBANIAN AND ENGLISH, nën kujdesin e pedagoges Dr. Etleva Babameto</p>
--	--	--

Tabela 6

Veprimtaritë e zhvilluara nga pedagogët - v.a. 2019 - 2020				
Konferenca	Publikime në revista shkencore	Libra/ monografi	Leksione të hapura	Tjetër (si projekte, etj.)
Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike				
44	32	1	1	29
Fakulteti i Shkencave Mjekësore				
28	37		3	4
Fakulteti i Shkencave Shoqërore				
32	32		6	9

Tabela 7

Veprimtaritë e zhvilluara nga studentët v.a. 2019 - 2020		
Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike		
Konferenca studentore	Aktivitete ekstrakurrikulare	Tjetër
Konferenca e II ^{të} Studentore “Inovacion në Inxhinieri, Shkencë dhe Teknologji” - 05.06.2020.	Leksion në kuadër të këshillimit të karrierës “Freelancer - Mundësi punësimi” - 21.02.2020. Panair pune në Zoom për studentët/të diplomuarit në “Inxhinieri Kompjuterike”/”Teknologji Informacioni” - 28.05.2020.	“Dita Kombëtare Informuese Erasmus+“ - 17.12.2019. Dita informuese mbi programet e ofruara për maturanët e Shkollës së mesme profesionale “Don Bosko” - 14.02.2020.
Fakulteti i Shkencave Mjekësore		
Konferenca e 14-të studentore e Departamentit të Stomatologjisë “Evolution of oral care and clinical dentistry - Neë challenges during COVID-19 pandemic”, 23 Shtator 2020, Tiranë Konferenca studentore me titull: “Praktikat e reja Infermierore dhe	Kongresi i 8 Botëror Virtual i Studentëve Dentarë - organizuar nga European Dental Students Association (EDSA), 20-22 Maj 2020, Zagreb.	Isai R, “Trauma from Occlusion and it’s radiographic detection” 21 april, 2020. EDSA Magazine - Spring 2020 Tarja M, “Geriatric patient: Data on dental problems at this age”, Arch Intern Med Res, 2019;2(4):070-076. (Publikime te Studenteve, Viti IV, V Stomatologji, AU).

Fizioterapeutike”, 29/10/2020		
Fakulteti i Shkencave Shoqërore		
